

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 10-16.02.2025

Janë testuar gjithsej 359 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=328) është shënuar një rritje prej 9,5%.

Janë regjistruar 3 raste pozitiv, 1 më pak se javën që shkoi.

Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 10-16.02.2025

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
10.2.2025	88	0	0,0%
11.2.2025	55	0	0,0%
12.2.2025	57	0	0,0%
13.2.2025	59	0	0,0%
14.2.2025	61	3	4,9%
15.2.2025	28	0	0,0%
16.2.2025	11	0	0,0%
Gjithsej	359	3	Mesatarisht 0,7%

Personat e sëmurë gjatë javës që shkoi janë nga Shkupi.

Gjatë javës së kaluar (10-16.02.2025) janë regjistruar si të shëruar 3 persona, ndërkohë që është nuk janë raportuar raste të vdekjes si pasojë e COVID-19.

GJENDJA ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2025

Gjatë vitit 2025, deri më 16.02.2025, janë regjistruar gjithsej 27 raste me COVID-19. Në muajin janar të vitit 2025 (20) numri i të sëmurëve është për 3,3 herë më i lartë se sa në muajin dhjetor 2024 (n=6).

Gjatë vitit 2025, deri më 09.02.2025, janë testuar gjithsej 2.061 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

Vlerësimi i rrezikut

Shkalla e ulët e transmetimit të SARS-CoV-2, rënia e numrit të raportimeve dhe testimeve ndikon në aftësinë për vlerësimin e gjendjes epidemiologjike. Popullata e EU/EEA në përgjithësi ka një nivel të konsiderueshëm të imunitetit hibrid (vaksinim/vaksinim me booster doza), që ofron një mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 17.02.2025

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>